

VENDIM
Nr.22, datë 14.2.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË
LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET
EKZISTUESE ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW PËR PERIUDHËN
1 MARS 2008 – 28 SHKURT 2009**

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Bordi Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2008, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për periudhën 1 mars 2008 – 28 shkurt 2009,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për periudhën 1 mars 2008 – 28 shkurt 2009, është 6.50 lekë/kwh.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i Ere-s
Bujar Nepravishta